SICC Coatings GmbH, 13156 Berlin / Germany, Wackenbergstraße 78 – 82, Tel.: +49 (0)30 500196-0, Fax.: -20, E-Mail: info@sicc.de

# Fleta terknike: ZincPrimer

## Përshkrimi i produktit

*ZincPrimer* është një material ndërmjetës ngjitës i ujshëm për metale jo me bazë hekuri për mjedise të brendshme dhe të jashtëme mbi bazën e rrëshirave akrilate.

## Lëndët përbërëse

Dispersion Polyacrylati, dioksid titani, ujë, glykol propileni, konservantë

## Grupi i produktit / kodi GIS

BSW20

Vlejnë të dhënat e vletës aktuale të sigurisë.

## Fusha e përdorimit

*ZincPrimer* përdoret si ndërmjetësues në ngjitje për metale jo hekur, si zing, çelik të zinguar, çelik inoksidabël, alumin dhe bakër. Ai mund të përdoret edhe si mbrojtje e lehtë kundër korrozionit i vendosur mbi sipërfaqe hekuri dhe çeliku.

## Veçoritë specifike të produktit

ZincPrimer nuk përmban lëndë tretëse, plumb dhe krom. Shtresa që thahet shpejt siguron një bazë shumë të mirë për shtresa të tjera të Produkteve *ClimateCoating*®.

**Të dhënat teknike:**
- Dendësia: 1,40 kg/m3 sipas ISO 2811-1
- Vlera e PH-it: 8,80- 9,20 DIN 19266

## Rregullat për lidhjet organike të çlirueshme (EG)

Vlera kufitare që prej 01.01.2010 për llaqet sspeciale njëkomponetësh (katalogu produktit i) = 140 g/l.

Ky produkt përmban < 30 g/l VOC

## Përgatitja e bazës

Zingu dhe sipërfaqet e zinguara duhen pastruar me një pastrues me përmbajtje amoniaku. Alumini dhe bakri pastrohen nga vajrat me hollues nitrik.

## Përpunimi

Përpunimi mund të kryhet me furçë, rul ose sprucim. *ZincPrimer* është një produkt i gatshëm për t´u punuar me furçë, rul dhe aparat sprucimi pa ajër.

Në rastin e punës me pistoleta me rezervuar të vogël *ZincPrimer* duhet holluar me ujë në masën 10%. Nëse përdoren aparate sprucimi, atëherë duhen të respektohen rregullat e prodhuesit të tyre. Gjatë përpunimit duhet të kihet gjithashtu kujdes që të mos kalohet temperatura minimale prej (5°C) e krijimit të shtresës së filmit. Kjo vlen edhe për të gjithë kohën e tharjes. Para përdorimit dha pas një kohe të gjatë të ndërprerjes së punës, materiali duhet të përzihet pak.

*ZincPrimer* është pas afërsisht 2 orësh i gatshëm për t´u hedhur mbi të shtresa e bojës. Pas 24 orësh është i tharë krejtësisht dhe pas 5-7 ditësh arrin fortësinë e tij.

## Konsumi

Konsumi i *ZincPrimer* është rreth 110 ml/m² me një shtresë të trashë prej 20 µm.

## Pastrimi i veglave të punës

Rulat, furçat dhe aparatet e sprucimit duhen larë shumë mirë menjëherë me ujë pas përdorimit.

## Toni i ngjyrës

*ZincPrimer* përftohet me ngjyrë të bardhë.

## Magazinimi dhe transporti

*ZincPrimer* magazinojeni dhe transportojeni freskët, por jo në ngrirje. Enët e përdorura mbyllini mirë dhe mundësisht përdorini shpejt. Mund të ruhet në magazinë deri 12 muaj nga data e prodhimit.

## Forma e Furnizimit

2,5 Litra, 10 Litra

Madhësi të tjera enësh në varësi të kërkesës.

## Flakja e produktit

Mbetjet e produkteve mos i lini të bien në kana-le, në ujra mbitëkësore apo në brendësi të tokës.

Dërgoni për riciklim vetëm enët boshe dhe pa mbetje. Mbetjet e produktit dorëzojini në vendet e përcaktuara për këtë qëllim.

Kodi i mbeturinës- Nr. 080120 sipas listës së EU për mbetjet.

## Udhëzime sigurie

Mbetjet e produkteve mos i lini të bien në kanale, në ujra mbitëkësore apo në brendësi të tokës.

Dërgoni për riciklim vetëm enët boshe dhe pa mbetje. Mbetjet e produktit dorëzojini në vendet e përcaktuara për këtë qëllim.

Kodi i mbeturinës- Nr. 080120 sipas listës së EU për mbetjet.

## Udhëzime sigurie

Përmbajtja e fletës teknike nuk krijon marëdhënie kontraktuale ligjore.

Përdoruesi apo blerësi duhet të testojë në çdo rast, në kushte praktike, aftësinë e materialit para përdorimit.

Mos lini që mbetjet e produktit të përfundojnë në kanalizime, ujra sipërfaqësore ose nëntokësore. Mbajeni larg prej ushqimeve, pijeve dhe ushqi-met e kafshëve. Mbrojeni nga ngacmimet e fëmijëve. Sipërfaqet që nuk duhen trajtuar duhet të mbrohen me anë të masave të duhura. Mbroni sytë dhe lëkurën nga sprucimi. Mos thithni me anë të frymëmarjes mjegullën që lind nga sprucimi gjatë punës.

Me daljen e një flete teknike të re, e kushtëzuar nga përmirësimi i produktit, të dhënat e paraqitu-ra humbasin vlefshmërinë e tyre.

Të dhënat e paraqitura janë vlerësuar nga SICC Coatings GmbH në laborator dhe praktikë si vlera udhëzuese. Informacionet mbi produktin rrjedhin nga njohuritë më të mira dhe përkojnë me nivelin e sotëm të teknikës. Ndikimet mje-disore, materialet e punës, aparaturat e aplikimit qëndrojnë jashtë ndikimit tonë dhe kështu jashtë përgjegjësisë tonë. SICC©2021